

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Kuvendi Komunal Skenderaj**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **643-26-566-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **001- Sigurimi Fizik i Objekteve të Komunës së Skenderajt**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

SKYFTERAT-LIVE SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR.REXHEP BISLIMI NR.1

(Adresa)

FERIZAJ

(Vendi)

70 000

(Kodi postar)

048/100-800

(Numri Telefonit)

NUK APLIKOHET

(Numri i Faks-it)

NJAZI SYLA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

skyfterat-live@hotmail.com

(Adresa elektronike)

14.09.2026

(Data e parashtrimt të ankesës)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Lënda: Shërbime

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur

FPP fjalori kryesor: 93000000-8 Shërbime të ndryshme

Vlera e parashikuar: 790,000.00€ (e madhe)

B05 Njoftimi për Kontratë

Data 20.02.2026

Afati për dorëzimin e tenderëve:

Data: 19.05.2026 – Ora: 14:00

Njoftimi mbi vendimin e AK-së:

Data: 24.08.2026

Kriteri për dhënien e kontratës:

√ Çmimi më i ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Jo, nuk kemi marr pjesë, hapja e ofertave është bërë në mënyrë elektronike përmes platformës së E-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒ ☐

Po, jemi njoftuar përmes njoftimit mbi vendimin e AK-së.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Legjislacioni primar -

1. Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

- Neni 1 - Qëllimi,
- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti,
- Neni 7 - Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi,
- Neni 28 - Specifikimet teknike,
- Neni 31 - Ekzekutimi i kontratave,
- Neni 51 - Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes,
- Neni 52 - Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës,
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve.

- Legjislacioni sekondar –

2. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

- Neni 25 - Kriteret e përzgjedhjes,
- Neni 27 - Kriteret e dhënies së kontratës,
- Neni 38 - Sqarimi i Tenderëve,
- Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve,
- Neni 41 - Tenderët Jo-normalisht të Ulët,
- Neni 45 - Procedura e Hapur.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Në afatin e lejuar ligjor, në mbështetje të **Nenit 109** të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe **Nenit 4.1.26 të LPP-së**, Operatori Ekonomik: SKYFTERAT-LIVE SH.P.K., në cilësinë e palës së interesit, paraqet këtë Ankesë lidhur me procedurën e prokurimit:

Titulli: 001 – Sigurimi Fizik i Objekteve të Komunës së Skenderajt

Nr. i prokurimit: 643-26-566-2-1-1

Vlera e parashikuar e kontratës: 790,000.00 EUR

Kundër: B58 – Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, datë 24.08.2026, me të cilin është rekomanduar për dhënie të kontratës GOE: **IMPERIAL SECURITY SH.P.K. & DELTA SECURITY SH.P.K.** me vlerë të ofertës prej **737,130.24 €**.

I. OBJEKTI I KËRKESËS

SKYFTERAT-LIVE SH.P.K., në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës dhe palës së interesuar, brenda afatit ligjor paraqet këtë **Kërkesë për Rishqyrtim**, duke kundërshtuar si:

- **eliminimin e tenderit të SKYFTERAT-LIVE SH.P.K., ashtu edhe rekomandimin për kontratë të GOE IMPERIAL SECURITY SH.P.K. & DELTA SECURITY SH.P.K.**

Sipas B58, SKYFTERAT-LIVE ka ofertuar në vlerë prej **726,105.60 €**, ndërsa GOE i rekomanduar ka ofertuar **737,130.24 €**. Vendimi për rekomandimin e GOE IMPERIAL SECURITY & DELTA SECURITY është nxjerrë më 24.08.2026.

Rrjedhimisht, oferta e SKYFTERAT-LIVE është:

11,024.64 € më e ulët se oferta e operatorit të rekomanduar.

Prandaj, eliminimi i tenderit tonë ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe vendimtar në rezultatin përfundimtar të aktivitetit të prokurimit.

Konsiderojmë se gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk është aplikuar në mënyrë të njëtrajtshme standardi i verifikimit të kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, konform Nenit 59.4 të LPP-së.

Nëse një dokument, mangësi apo mungesë verifikimi është konsideruar esenciale për eliminimin e SKYFTERAT-LIVE, **e njëjta kërkesë dhe i njëjti standard duhet të aplikohen edhe ndaj operatorit të rekomanduar për kontratë.**

II. PRETENDIMET ANKIMORE

1. KUNDËRSHTIMI I ELIMINIMIT LIDHUR ME SISTEMIN PËR MONITORIMIN E ROJEVE

Një prej arsyeve kryesore të eliminimit tonë lidhet me sistemin për monitorimin e rojeve.

Në Letrën standarde B42, AK ka konstatuar se është kërkuar sistem i monitorimit të rojeve dhe ka kërkuar dëshmi konkrete dhe të verifikueshme lidhur me:

- **ekzistencën, implementimin, funksionalitetin dhe demonstrimin praktik të sistemit.**

AK ka kërkuar madje që sistemi të mund të jetë i qasshëm për verifikim nga Komisioni i Vlerësimit.

Pikërisht mbi këtë bazë juridike dhe faktike kundërshtojmë përgjegjshmërinë e GOE të rekomanduar.

Nga çfarë është konstatuar se IMPERIAL SECURITY SH.P.K. & DELTA SECURITY SH.P.K. e posedon realisht sistemin e kërkuar?

Nuk mjafton që operatori të paraqesë një dokument përshkrues, deklaratë, fotografi, screenshot, broshurë, specifikim teknik apo premtim se sistemi do të vihet në funksion gjatë ekzekutimit të kontratës.

Nëse ndaj SKYFTERAT-LIVE është kërkuar **demonstrim praktik**, atëherë kërkojmë që AK të dëshmojë se të njëjtin demonstrim praktik e ka kërkuar dhe realizuar edhe ndaj GOE të rekomanduar.

Konkretisht kërkojmë të sqarohet:

- **A është verifikuar fizikisht sistemi i kompanisë IMPERIAL SECURITY?**
- **Në cilën datë dhe në cilin lokacion është bërë verifikimi?**
- **Cilët anëtarë të Komisionit të Vlerësimit kanë qenë të pranishëm?**
- **A është demonstruar funksionimi real i sistemit?**
- **A është testuar web-aplikacioni dhe qasja përmes kredencialeve?**
- **A është demonstruar monitorimi i rojeve në kohë reale?**
- **A është testuar ndonjë pikë kontrolli, alarm, raportim apo funksionalitet tjetër i kërkuar?**
- **A ekziston procesverbal, raport teknik apo dëshmi tjetër e Komisionit për këtë verifikim?**

Nëse Komisioni **nuk ka qenë fizikisht për ta verifikuar dhe demonstruar sistemin**, atëherë shtrohet pyetja thelbësore se mbi çfarë baze është konstatuar se GOE i rekomanduar e posedon sistemin dhe plotëson kriterin.

AK nuk mund të kërkojë nga një operator **ekzistencë + implementim + funksionalitet + demonstrim praktik**, ndërsa ndaj operatorit tjetër të pranojë vetëm dokumentacion formal.

Kriteri është i njëjtë dhe, rrjedhimisht, standardi i provueshmërisë duhet të jetë i njëjtë.

2. LISTA PREJ SË PAKU 33 PUNËTORËVE DHE PARAKONTRATAT

AK e ka konsideruar ofertën tonë të papërgjegjshme edhe lidhur me listën e stafit prej së paku **33 punëtorëve**, duke konstatuar mangësi në disa parakontrata dhe duke kërkuar dokumentacion shtesë për verifikimin e autenticitetit të tyre.

Kundërshtojmë mënyrën e aplikimit të këtij kriteri.

Nëse AK ka konsideruar se për SKYFTERAT-LIVE është i nevojshëm kontrolli individual i parakontratave, nënshkrimeve, datave dhe identitetit të personave, atëherë **pikërisht i njëjti kontroll duhet të jetë kryer për secilin punëtor të deklaruar nga IMPERIAL SECURITY & DELTA SECURITY.**

Sipas dokumentacionit të dorëzuar të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë përmes e-mail, **mungojnë kontratat apo parakontratat për 33 punëtorët e propozuar.**

Kërkojmë që gjatë rishqyrtimit të kontrollohen individualisht:

- lista e punëtorëve;
- parakontratat/kontratat për secilin person;
- nënshkrimet dhe datat;
- identifikimi i palëve;
- disponueshmëria reale e personelit;
- dokumentet mbështetëse të kërkuara nga DT;
- përputhshmëria ndërmjet listës së stafit dhe dokumenteve individuale.

Nëse tek GOE i rekomanduar ekziston qoftë edhe e njëjta kategori e mangësive për të cilat është eliminuar SKYFTERAT-LIVE, AK nuk mund t'i japë atyre efekt juridik të ndryshëm, pra AK nuk ka bërë trajtimin e ofertave konform Nenit 7 të LPP-së, përkundrazi ka përdorur standard të dyfishtë.

3. MARRËVESHJA ME INSTITUCIONIN/QENDRËN E TRAJNIMIT NUK DËSHMOHET SI VALIDE

Dosja e Tenderit ka përcaktuar shprehimisht si dëshmi:

“5. Të dëshmohet me marrëveshje, dhe licencat e qendrës/institucionit të trajnimit (kopje e marrëveshjes, licencat kopje).”

Kjo kërkesë nënkupton se operatori ekonomik duhet të paraqesë marrëveshje valide, përmes së cilës dëshmohet se në momentin relevant ekziston marrëdhënia juridike dhe bashkëpunimi me institucionin e licencuar të trajnimit.

Mirëpo, dokumenti i dorëzuar nga GOE IMPERIAL SECURITY SH.P.K. & DELTA SECURITY SH.P.K. përmban një dispozitë që e vë seriozisht në pikëpyetje përmbushjen e këtij kriteri.

Konkretisht, në **Nenin 4 – “Vlefshmëria e Marrëveshjes”**, pika 1, është përcaktuar:

“Kjo marrëveshje mbetet në fuqi për aq kohë sa Kompania e Sigurimit ka kontratë aktive me institucionin publik përkatës në aktivitetin e prokurimit të sipërshtënuar.”

Vetë marrëveshja e identifikon aktivitetin konkret si “001 – Sigurimi Fizik i Objekteve të Komunës së Skenderajt”, nr. 643-26-566-2-1-1.

Kjo dispozitë është thelbësore.

Në momentin e ofertimit dhe vlerësimit, GOE IMPERIAL SECURITY & DELTA SECURITY **nuk kishte kontratë aktive me Komunën e Skenderajt për këtë aktivitet prokurimi**, sepse kontrata ende nuk ishte dhënë dhe procedura ishte në fazën e tenderimit/vlerësimit.

Përkundrazi, vetë Njoftimi mbi vendimin e AK-së B58 tregon se IMPERIAL/DELTA **vetëm është rekomanduar për dhënie të kontratës më 24.08.2026**, pra nuk mund të barazohet rekomandimi për kontratë me ekzistencën e një kontrate aktive.

Rrjedhimisht krijohet një kundërthënie e qartë ndërmjet **Nenit 5 dhe Nenit 4** të vetë marrëveshjes: Neni 5 parashikon hyrjen në fuqi me nënshkrim, ndërsa Neni 4 e lidh vlefshmërinë e saj me ekzistencën e një “kontrate aktive” me institucionin publik për aktivitetin konkret.

Pikërisht për këtë arsye AK nuk ka mundur ta konsiderojë automatikisht këtë dokument si dëshmi të pakontestueshme të përmbushjes së kriterit pa e sqaruar këtë kundërthënie.

Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar një premtim për lidhjen apo aktivizimin e marrëveshjes në të ardhmen, pas fitimit të kontratës; ka kërkuar që kriteri të dëshmohet me marrëveshje dhe licencat përkatëse.

Nëse vlefshmëria e marrëveshjes, sipas vetë Nenit 4 të saj, kushtëzohet me faktin që operatori **“ka kontratë aktive”** me institucionin publik për aktivitetin konkret, atëherë AK duhet të sqarojë:

Si është konsideruar kjo marrëveshje valide në momentin e dorëzimit dhe vlerësimit të tenderit, kur IMPERIAL SECURITY & DELTA SECURITY në atë moment nuk kishte kontratë aktive me Komunën e Skenderajt për aktivitetin nr. 643-26-566-2-1-1?

Për më tepër, marrëveshja është nënshkruar më 14.04.2026 nga institucioni trajnues dhe nga përfaqësuesi i GOE, por data e nënshkrimit nuk e eliminon kushtin material të përcaktuar nga vetë palët në Nenin 4 lidhur me vlefshmërinë e saj.

Prandaj, konsiderojmë se AK ka qenë i obliguar të verifikojë nëse ky dokument përbënte **marrëveshje valide dhe efektive në momentin relevant të procedurës**, dhe jo marrëveshje efektet e së cilës varen nga një ngjarje e ardhshme – fitimi dhe aktivizimi i kontratës publike.

Nëse kriteret e Dosjes së Tenderit duhet të plotësohen dhe dëshmohen në procedurën e tenderimit, ato **nuk mund të konsiderohen të plotësuara mbi bazën e një dokumenti vlefshmëria e të cilit kushtëzohet me lidhjen/aktivizimin e kontratës që operatori ende është duke konkurruar për ta fituar.**

Për këto arsye kërkojmë që AK gjatë rishqyrtimit:

- **të konstatojë se marrëveshja e paraqitur nga IMPERIAL SECURITY & DELTA SECURITY nuk ka qenë juridikisht valide dhe efektive në momentin e ofertimit; dhe të konstatojë se kriteri i përcaktuar në pikën 5 të Dosjes së Tenderit nuk është dëshmuar në mënyrën e kërkuar.**

Dokumenti është i paqartë dhe kontradiktor për vlefshmërinë e kërkuar nga DT, dhe AK duhej ta zgjidhte këtë çështje para se ta shpallte IMPERIAL-in të përgjegjshëm.

4. KUNDËRSHTIMI I DOKUMENTACIONIT TË MENAXHERËVE

Në mënyrë të veçantë kundërshtojmë konstatimin se GOE IMPERIAL SECURITY & DELTA SECURITY se i plotëson kërkesat lidhur me **menaxherin dhe ndihmës-menaxherët**.

Kërkojmë që gjatë rishqyrtimit AK të bëjë verifikim substancial dhe individual të dokumenteve të secilit person të propozuar.

Nuk është e mjaftueshme që në ofertë të jetë vendosur vetëm emri i një personi apo një dokument i titulluar si vendim, CV, referencë ose parakontratë.

Duhet të verifikohet nëse dokumentacioni provon realisht:

- **përvojën e kërkuar profesionale;**
- **kohëzgjatjen e përvojës;**
- **pozitën konkrete të ushtruar;**
- **kontratën/parakontratën valide;**
- **disponueshmërinë për realizimin e kësaj kontrate;**
- **certifikatat dhe kualifikimet e kërkuara;**

si dhe përputhshmërinë e plotë të secilit dokument me kërkesën përkatëse të DT-së.

Nëse AK ka verifikuar deri në nivel të nënshkrimeve dhe datave dokumentacionin e SKYFTERAT-LIVE, nuk ekziston bazë ligjore që dokumentet e menaxherëve të GOE të rekomanduar të trajtohen vetëm formalisht.

Kërkojmë që AK gjatë rishqyrtimit të tregojë konkretisht, për secilin menaxher dhe ndihmës-menaxher, dokumentin me të cilin është përmbushur secila kërkesë e DT-së.

5. PESË PUNËTORËT E CERTIFIKUAR PËR MBIKËQYRJE ELEKTRONIKE DHE MENAXHERI OME

Në arsyetimin e eliminimit, AK ka evidentuar edhe kërkesën për minimum **5 punëtorë të certifikuar për mbikëqyrje elektronike dhe një menaxher të certifikuar për OME**, si dhe ka ngritur çështje lidhur me dëshmitë për përvojën e punës të stafit të propozuar nga SKYFTERAT-LIVE.

Për rrjedhojë, i njëjti kontroll duhet të aplikohet ndaj GOE të rekomanduar.

Nëse kriteri kërkon jo vetëm certifikim, por edhe përvojë profesionale, atëherë **certifikata në vetvete nuk e dëshmon përvojën e punës**.

Për secilin person duhet të ekzistojë dokumentacion që dëshmon në mënyrë të verifikueshme përvojën e kërkuar.

Kërkojmë që AK të verifikojë:

certifikatat përkatëse, validitetin e tyre, datën e certifikimit, përvojën pas certifikimit nëse kjo është kërkuar, kontratat e punës, referencat dhe çdo dëshmi tjetër të përcaktuar në DT.

Nëse ndonjëri nga personat e paraqitur nga IMPERIAL/DELTA nuk e dëshmon kriterin në mënyrën e kërkuar, oferta nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme vetëm mbi bazën e një deklarimi formal.

6. POLICA E SIGURIMIT SHËNDETËSOR DHE AKSIDENTEVE PERSONALE

Një arsye tjetër e përdorur ndaj ofertës sonë lidhet me **parakontratën/policën për sigurimin shëndetësor dhe aksidentet personale në grup**, ku AK ka ngritur çështje lidhur me nënshkrimet, vulat dhe identifikimin e personit ose pozitës së nënshkruesit.

Kërkojmë që i njëjti standard të aplikohet ndaj dokumentit përkatës të GOE IMPERIAL SECURITY & DELTA SECURITY.

Duhet të verifikohet:

- **vlefshmëria e dokumentit, palët kontraktuese, nënshkrimet, autorizimi i nënshkruesve, periudha e mbulimit, objekti i sigurimit dhe përputhshmëria e plotë me kërkesën e DT-së.**

Nuk mund të konsiderohet një element formal esencial për eliminimin e një operatori dhe joesencial për operatorin tjetër.

7. STANDARD I DYFISHTË NË VLERËSIMIN E TENDERËVE

Thelbi i kësaj kërkeje nuk qëndron vetëm në secilën mangësi individuale.

Çështja kryesore është:

A është përdorur i njëjti standard i vlerësimit dhe verifikimit ndaj SKYFTERAT-LIVE dhe ndaj IMPERIAL SECURITY & DELTA SECURITY?

Nga B42 rezulton se ndaj SKYFTERAT-LIVE është aplikuar një kontroll rigoroz që ka përfshirë parakontratën, nënshkrimet, datat, përvojën profesionale, dokumentet e stafit dhe madje ekzistencën, implementimin, funksionalitetin dhe demonstrimin praktik të sistemit të monitorimit.

Ne nuk kundërshtojmë të drejtën e AK-së për të verifikuar dokumentacionin.

Kundërshtojmë aplikimin eventual të një standardi më të favorshëm ndaj operatorit të rekomanduar.

Në prokurimin publik duhet të vlejë parimi:

I njëjti kriter duhet të verifikohet me të njëjtin standard dhe e njëjta mangësi duhet të prodhohet të njëjtën pasojë juridike për secilin tenderues.

Prandaj:

Nëse mungesa e demonstrimit praktik të sistemit është shkak eliminimi për SKYFTERAT-LIVE, i njëjti standard duhet të vlejë për IMPERIAL/DELTA.

Nëse mangësitë e parakontratave janë shkak eliminimi për SKYFTERAT-LIVE, të njëjtat mangësi duhet të kenë të njëjtën pasojë për IMPERIAL/DELTA.

Nëse mangësitë në dokumentet e menaxherëve janë esenciale për SKYFTERAT-LIVE, duhet të jenë esenciale edhe për IMPERIAL/DELTA.

Nëse kërkohet dëshmi konkrete e përvojës për stafin tonë, e njëjta dëshmi duhet të kërkohet edhe nga stafi i operatorit të rekomanduar.

Çdo qasje tjetër cenon trajtimin e barabartë të operatorëve dhe objektivitetin e procesit të vlerësimit.

8. AK DUHET TË VLERËSOJË PËRMBAJTJEN REALE TË DOKUMENTEVE DHE JO VETËM EKZISTENCËN E TYRE

Në procedurën e rivlerësimit nuk mjafton që Komisioni të konstatojë se një dokument gjendet në ofertën e IMPERIAL/DELTA.

Duhet të verifikohet nëse **përmbajtja e dokumentit plotëson kriterin konkret.**

Ekzistenca e një dokumenti me titull “Menaxher”, “Referencë”, “Parakontratë”, “Sistem i monitorimit”, “Certifikatë” apo “Policë sigurimi” nuk do të thotë automatikisht se kriteri është përmbushur.

Kjo është pikërisht logjika që AK ka përdorur gjatë vlerësimit të ofertës sonë.

Prandaj kërkojmë që e njëjta metodologji të zbatohet edhe ndaj operatorit të rekomanduar.

9. ELIMINIMI I SKYFTERAT-LIVE KA NDIKUAR DREJTPËRDREJT NË REZULTATIN E PROCEDURËS

Ky fakt është veçanërisht i rëndësishëm.

Sipas vetë Njoftimit mbi vendimin e AK-së B58:

SKYFTERAT-LIVE SH.P.K. – 726,105.60 €

IMPERIAL SECURITY SH.P.K. & DELTA SECURITY SH.P.K. – 737,130.24 €.

Pra:

SKYFTERAT-LIVE është 11,024.64 € më i lirë.

Për rrjedhojë, eliminimi i tenderit tonë nuk është një çështje pa ndikim në rezultatin përfundimtar.

Nëse pas rishqyrtimit konstatohet se arsyet e eliminimit tonë nuk qëndrojnë, ose se operatori i rekomanduar nuk plotëson me të njëjtin standard kriteret për të cilat është eliminuar SKYFTERAT-LIVE, atëherë **vendimi për dhënie nuk mund të mbetet në fuqi.**

10. MOSPËRPUTHJA NDËRMJET ANALIZËS FINANCIARE DHE ÇMIMIT TË OFERTËS

Kundërshtojmë përgjegjshmërinë e ofertës së GOE IMPERIAL SECURITY & DELTA SECURITY, pasi ekziston mospërputhje ndërmjet Analizës Financiare të dorëzuar nga vetë operatori dhe çmimit përfundimtar të ofertës.

Në Analizën Financiare, operatori ka përcaktuar shprehimisht:

“Totali – Kosto për 24 muaj: 737,195.88 €”, duke e paraqitur këtë si koston totale të realizimit të kontratës.

Ndërsa në dokumentin e çmimit, totali i ofertuar është 624,686.64 € pa TVSH, që me TVSH rezulton në 737,130.24 €, njëkohësisht edhe çmimi me të cilin është rekomanduar për kontratë.

Pra:

Kosto finale sipas Analizës Financiare: 737,195.88 €

Çmimi përfundimtar i ofertës: 737,130.24 €

Diferenca: 65.64 €

Kjo nënkupton se çmimi i ofertuar është më i ulët se vetë kostoja finale që operatori ka deklaruar se i nevojitet për realizimin e kontratës.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga AK të sqarojë këtë mospërputhje dhe të verifikojë se si është konsideruar oferta e përgjegjshme, kur nga vetë analiza financiare e operatorit rezulton se kostoja e deklaruar për realizimin e kontratës është më e lartë se çmimi me të cilin ai ka ofertuar dhe është rekomanduar për kontratë.

III. KËRKESA – PETITUMI

Duke u bazuar në faktet dhe pretendimet e paraqitura më sipër, **SKYFTERAT-LIVE SH.P.K. kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:**

- 1. TË APROVOJË** si të bazuar Ankesën e SKYFTERAT-LIVE SH.P.K.;
- 2. TË ANULOJË** B58 – Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 24.08.2026, për rekomandimin për kontratë të GOE IMPERIAL SECURITY SH.P.K. & DELTA SECURITY SH.P.K.;
- 3. TË KTHEJË** aktivitetin e prokurimit nr. **643-26-566-2-1-1** në **RIVLERËSIM**;
- 4. TË RIVLERËSOJË** ofertën e SKYFTERAT-LIVE SH.P.K. dhe të gjitha arsyet mbi të cilat është bazuar eliminimi ynë;
- 5. TË VERIFIKOJË** me të njëjtin standard ofertën e GOE IMPERIAL SECURITY SH.P.K. & DELTA SECURITY SH.P.K., veçanërisht lidhur me:

sistemin për monitorimin e rojeve; ekzistencën dhe funksionalitetin real të tij; demonstrimin praktik; listën prej së paku 33 punëtorëve; parakontratat; menaxherin dhe ndihmës-menaxherët; 5 punëtorët e certifikuar për mbikëqyrje elektronike; menaxherin e certifikuar për OME; përvojën profesionale; dhe dokumentacionin për sigurimin shëndetësor dhe aksidentet personale;
- 6. TË DËSHMOJË**, lidhur me sistemin e monitorimit të operatorit të rekomanduar, nëse është kryer demonstrimi praktik, kur është kryer, ku është kryer, nga cilët anëtarë të Komisionit është verifikuar dhe mbi cilin dokument/procesverbal është konstatuar funksionaliteti i tij;
- 7. TË APLIKOJË** standard të njëjtë të ekzaminimit dhe vlerësimit për të gjithë operatorët ekonomikë, pa trajtim të diferencuar;

dhe, pas rivlerësimit,
- 8. TË NXJERRË VENDIM TË RI** në përputhje me LPP-në dhe Dosjen e Tenderit dhe të rekomandojë për kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm sipas kriterit të dhënies.

IV. PËRFUNDIM

SKYFTERAT-LIVE SH.P.K. konsideron se pretendimet e kësaj kërkesë kërkojnë **rivlerësim real dhe jo vetëm konfirmim formal të vendimit paraprak.**

Në veçanti, kërkojmë përgjigje konkrete në pyetjen:

Nëse nga SKYFTERAT-LIVE është kërkuar demonstrimi praktik dhe verifikimi i funksionalitetit të sistemit, ku është dëshmia se i njëjti verifikim është bërë edhe ndaj IMPERIAL SECURITY & DELTA SECURITY?

Në mungesë të një dëshmie të tillë, nuk mund të aplikohet një standard më i rëndë ndaj operatorit të eliminuar dhe një standard më i lehtë ndaj operatorit të rekomanduar.

E njëjta logjikë vlen për **parakontratat, stafin, menaxherët, certifikatat, përvojën profesionale dhe policën e sigurimit.**

Për më tepër, SKYFTERAT-LIVE ka ofertuar **11,024.64 € më lirë** se operatori i rekomanduar, prandaj korigjimi i vlerësimit mund të ndryshojë drejtpërdrejt rezultatin e aktivitetit të prokurimit.

Për këto arsye kërkojmë **anulimin e vendimit të kontestuar dhe kthimin e aktivitetit në rivlerësim të plotë, objektiv dhe të barabartë.**

Në të kundërtën, rezervojmë të drejtën që, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, të vazhdojmë me **mjetet juridike pranë organeve kompetente**, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesit tonë juridik.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si palë e interesit në këtë aktivitet të prokurimit na janë krijuar shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit (ofertës) dhe pjesëve të tjera të cilat ndërlidhen me këtë aktivitet të prokurimit si: shpenzimet për përgatitjen e ankesave si në fazën e parë dhe atë të dytë, përfaqësimeve të cilat mund të ndodhin etj.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.